



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

09-01-2021



Prishtinë / Priština

Nr./Br. 29-2021

U skladu sa ovlašćenjima datim članom 64.2 Zakona Br.03/L-073, o Opštim izborima u Republici Kosovo, Centralna izborna komisija na redovnom sastanku održanom 08.01.2021, donosi:

ODLUKA

O usvajanju Analize i Izveštaja iz nalaza o identifikaciji nedostataka i izazova obuke tokom izbornih procesa 2009-2019

- I. Usvaja se Analiza i Izveštaj iz nalaza o identifikaciji nedostataka i izazova obuke tokom izbornih procesa 2009-2019.
- II. Analiza iz tačke I je sastavni deo ove odluke.
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja iste.

Priština, 08.01.2021

Predsednica Centralne izborne komisije





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Divizioni i Trajnimeve

**Analizë dhe Raport nga të gjeturat për identifikimin e mangësive dhe sfidave
të trajnimit gjatë proceseve zgjedhore**

2009 - 2019

I. Hyrje

Duke u bazuar në planin e punës të KQZ-se për vitit 2020, shtylla e fuqizimit institucional pika 26 Identifikimi i mangësive/sfidave ne trajnimin e trupave zgjedhore, Divizioni i Trajnimit eshtë i obliguar të zhvillojë aktivitetet të cilat ndërlidhen me shqyrtim të modaliteteve të trajnimit, se si kanë funksionuar nga e kaluara, ne përbledhjen e te gjeturave, evidentimin e tyre dhe dhënien e propozimeve apo rekomandimeve duke i harmonizuar me raportet¹ e misioneve vendore dhe ndërkontaktuale² të vëzhgimit të zgjedhjeve. Përbledhja e të gjitha këtyre rekomandimeve në një raport dhe shqyrtimi në instancat e duhura për miratim, do të ndihmoj në përpjekjet për përmirësimin dhe avancimin e trajnimit si aspekt mjafte i rëndësishëm në përcaktimin e cilësisë se një procesi zgjedhore.

Ky aktivitet, sipas planit të punës ka qenë i paraparë të realizohet përmes gjashtë takimeve nëpër regjione te caktuara, por, në saje të gjendjes pandemike, kemi qenë të detyruar qe, këto takime ti zëvendësojmë përmes komunikimit elektronik duke kërkuar nga Zyrتaret e terrenit qe ti jasin disa te dhëna te mbarëvajtjes se trajnimeve ne terren. Njëkohësisht, te njëjtë kane paraqitur edhe propozimet/rekomandimet për secilin cikël te trajnimeve qe parashihen dhe organizohen ne çdo pale zgjedhje ne baze te Planit operacional.

Trajnimi si proces i mësimdhënies dhe mësim nxënies për ngritjen e kapaciteteve profesionale ne sektorin publik eshtë i një rëndësie te veçantë ne zbatimin e procedurave për mbarëvajtjen e proceseve administrative te mirëfillta. Në institucionin tonë trajnimi si pjesë integrale e Shtyllës se fuqizimit institucional bënë pjesë në operacionet zgjedhore, të cilat kane shtrirje mjaft komplekse si nga koha e realizimit ashtu edhe të përfshirje se afërsisht 20000 pjesëmarrësve ne 8 deri 9 cikle te trajnimeve te organzuara për çdo proces zgjedhore. Implementimi i programeve te trajnimeve ne vete ngërthen te mësuarit dhe te ushtruarit e te gjitha procedurave te parapara për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit te votimit, numërimit, paketimit te materialeve ne Vendvotim dhe shume çështje tjera te cilat e përbëjnë procesin e ditës se zgjedhjeve³.

Këto trajnime, përfshijnë po thua se te gjithë akteret pjesëmarrës ne proceset zgjedhore, duke filluar nga stafi i rekrutuar e deri tek te emëruarit e SP nga KQZ.

Aktivitete e trajnimit te cilat zhvillohen ne KQZ, kërkojnë mund dhe përkushtim për realizimin e tyre, duke u përballur me shumë sfida konform kushteve dhe rr Ethanave qe na diktohen jo rralle ne organizimin e zgjedhjeve te jashtëzakonshme dhe te parakohshme. Faktorët te cilët ndikojnë ne cilësinë e një trajnimi janë: targeti dhe numri i pjesëmarrësve, vendi ku zhvillohen, modalitetë e trajnimit, materialet e aplikuara, kombinimi i aspektit teorik dhe praktike ne sesionet e trajnimit, afatet e emërimit te trupave zgjedhore etj.

Divizioni i trajnimit si pjese përbërëse e operacioneve zgjedhore eshtë i përkushtuar ne hulumtimin analizën dhe gjetjen e metodave me te avancuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale te cilat do te ndikojnë ne përmirësimin dhe mënjanimin e parregullsive ne vendvotime, te cilat i kemi evidente ne çdo pale zgjedhje⁴

¹ <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/132-dnv-raporti-perfundimtar-zgjedhjet-parlamentare-2017-alb.pdf>

² https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/final_report_eom_kosovo_june_2017_albanian-1.pdf

³ <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-09-2013.pdf>

⁴ <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/132-dnv-raporti-perfundimtar-zgjedhjet-parlamentare-2017-alb.pdf>

IV. Konteksti i Analizës

Divizioni i trajnimit ne kuadër te obligimeve dhe përgjegjësive ligjore⁹ për çdo palë zgjedhje bënë planifikimin përgatitjen organizimin dhe mbikëqyrjen e gjithsejtë 8 deri 9 ciklev te trajnimeve, me afersisht 19000 pjesëmarrës. Këto trajnime, ngérthejnë ne vete një gamë procedurash që e përshkojnë procesin zgjedhore.

Eksperiencia nga e kaluara dhe raportimet nga misionet e ndryshme të vëzhgimit, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, janë tregues se ekziston një gatishmëri dhe përkushtim i pareshtur në arritjen e objektivave përmes përgatitjen sa me profesionale te infrastrukturës zgjedhore ne Institucionin tone, si të stafit që angazhohet gjatë proceseve zgjedhore në KQZ, ashtu edhe te trupave menaxhuese të cilët bëjnë implementimin e procedurave, përmes cilat ligjërisht janë te obliguar.

Mirëpo, përkundër përkushtimit dhe realizimit të gjitha trajnimeve me modulet përkatëse përmes se cilës procedure, raportet dhe te dhënët qe kemi në QNR, gjate pranimit dhe procedimit të materialeve në kategoritë e caktuara në bazë te gjendjes se kutive dhe materialeve tjera që pranohen ne këtë njësi, jashtë tregues që, lënë përmes dëshiruar më tepër nga procesi i trajnimit, përmes procedurat qe aplikohen ditën e Zgjedhjeve. Ne çdo pale zgjedhje përmes shkak te mospërputhjeve dhe gabimeve të bëra ne Plotësimin e FPR-se, paketimi jo i mire i materialeve zgjedhore, mospërputhjet gjate numërimit te votave me kusht etj. dëshmon punën jo profesionale te anëtarëve te KVV ne vendvotim.

Andaj, harmonizimi i rekomandimeve nga misionet e ndryshme te vëzhgimit si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, me të gjeturat nga raportet e analizave te bëra ne kuadër te Sekretariatit, që kemi hasur gjate proceseve zgjedhore ndër vitet e kaluara (2009-2019), janë te paraqitura ne këtë raport. Përbledhja e te gjitura nga analizat e bëra,¹⁰ janë tregues/referues ne parashtrimin e propozimeve/rekomandimeve te reja përmes cilat janë ballafaquar, ne mënyrë që në të ardhmen të shërbejnë si indikatorë te shtytës dhe te arsyeshëm përmes përgatitjen e cilësisë trajnimeve.

V. Metodologjia e punës ne përbledhjen e te gjeturave dhe identifikimin e sfidave qe kemi pasur ne implementimin e trajnimeve gjate proceseve zgjedhore

Për ta bërë analizën në identifikimin dhe evidentimin e të gjeturave/sfidave te cilat kemi pasur ndër vite ne proceset zgjedhore, janë ndjekur këta hapa:

- Është bërë grumbullimi i te dhënavë me te specifikuara lidhur me organizimin e trajnimeve dhe te gjeturat gjate implementimi te secilit cikël te trajnimit. Janë konsultuara raporte nga këndë vështirime te ndryshme përmes aspektin e mbarëvajtjes se trajnimeve.¹¹
- Me që, pjesa më e madhe e trajnimeve zhvillohen në terren, përmes një shkresë anketuese është kërkuar nga ZLKZ-te, në cilësinë e respondentëve, edhe ata te jashtë dhënët, komentet, sfidat me te cilat janë ballafaquar dhe rekomandimet se si te veprohet ne të ardhmen përmes gjitha ciklet e trajnimit.
- Pas përbledhjes se komenteve dhe rekomandimeve te ZLKZ-ve, është bërë klasifikimi dhe evidentimi i tyre, ne baze te kategorisë te cilën e kane propozuar përmes zhvillimin e trajnimeve ne të ardhmen.
- Pas përfundimit te konsultimeve me burimet (raporte te monitorimit nga qendra, raporte te vëzhgimit nga shume akter te jashtëm dhe anketa e realizuar me ZLKZ) rreth mënyrës se

⁹ https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-01_2017.pdf

Neni 15

¹⁰ https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/09/Analize%C3%AB-e-votave-me-asistenc%C3%AB-Zgjedhjet-e-parakohshme-p%C3%ABr-Kuvendin-e-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2019_ALB.pdf

¹¹ <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/132-dnv-raporti-perfundimtar-zgjedhjet-parlamentare-2017-alb.pdf>

7.1 Trajnimi i trajnerëve te qendrës

Ne fazën e pare te trajnimeve zhvillohen vetëm trajnimet për stafin e trajnimit te angazhuar ne qendër, dhe me pastaj këto trajnime vazhdojnë prej stafit te qendrës tek trajnerët e terrenit. Gjate këtyre trajnimeve behet përgatitja e trajnerëve për trajnimet e mëtejme qe do te zhvillohen për trajnerët e KKZ-ve dhe këta te fundit zhvillojnë trajnime për trupat menxuese të zgjedhje.

Numri i përafërt i stafit te trajnimit te rekrutuar ne qendër është 25, ndërsa ne terren afërsisht 300.

- Temat për te cilat trajnohen trajnerët e qendrës janë:
 - Procedurat e votimit dhe numërimit;
 - Procedurat e raportimit K-vote
 - Procedurat e VPKV-ve;
 - Procedurat e Pranim dorëzimit; dhe
 - Zhvillimi i monitorimit te trajnimeve ne teren;

Këto trajnime për temat e larte theksuar zhvillohen nga Udhëheqësi i Divizionit te trajnimit me lehtësim te disa trajnerëve me eksperience mbi 10 vjeçare qe kane punuar ne zgjedhje.

Trajnerët e qendrës përpos trajnimeve te cilat i ndjekin dhe i përsërisin gjate ditëve ne orare pune, te njëjtë janë te angazhuar edhe ne përgatitjen e materialeve te ndryshme te trajnimit te cilat nevojiten për trajnimet e mëtejme neper Komuna/KKZ (udhëzuesve, Agjendat, formularët për simulimin e ushtrimeve, printimin e materialeve te nevojshme gjate trajnimit, pyetësorët e ndryshëm, përgatisin raporte etj.).

Angazhimi i trajnerëve në qendër nga viti 2014 e deri ne zgjedhjet e fundit ne Podujeve dhe Mitrovicën e veriut, është bere pa procedura te rekrutimit, element përparrësie dhe lehtësues për angazhimin e tyre ishte eksperiencia e gjate dhe e njëpasnjëshme ne zgjedhjet paraprake.

Ndërsa, nga zgjedhjet e kaluara për Kryetar Komune ne Podujeve dhe Mitrovicë 2020 Procesi i angazhimit te trajnerëve ne qendër po ashtu edhe ne terren është bërë me zhvillimin e procedurave te rekrutimit.¹²

7.2 Trajnimet e trajnerëve te terrenit

Ky cikël i trajnimeve është e kategorisë se njëjtë si me larte, vetëm se ky staf i trajnimit i cili angazhohet ne terren, me tutje trajnimet i zhvillon për trupat menxuese te zgjedhjeve. Nëse i referohemi këtij cikli te trajnimeve dhe strukturës organizative për zhvillimin e këtij trajnimi, e përshkojnë dy periudha apo etapa kohore neper te cilat ka ndërruar modaliteti ne strukturën organizative te zhvillimit te këtij trajnimi.

Nga Viti 2009 deri 2016, këto trajnime janë zhvilluar në qendër nga Divizioni i trajnimit dhe stafi i trajnimit ne qendër. Gjate kësaj periudhe, Divizioni i trajnimit me përkrahjen administrative dhe organizative te njësive tjera ne Sekretariat ka bere përgatitjet, organizimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit, sipas përshkrimit ne vijim:

- Trajnerët e terrenit janë trajnuar vetëm për Procedurat e votimit, numërimit dhe paketimit.
- Trajnimi është zhvilluar ne agjende tri ditore
- Skema organizative e zhvillimit te trajnimit ishte si ne vijim: afërsisht deri ne **300** trajnerë të KKZ-ve, të ndarë në 12 seanca trajnimi. Seancat u zhvilluan ne tri dite radhazi me gjithsejtë 12 ekipe të trajnimit. Një ekip i trajnimit përbëhej nga 2 deri ne 3 trajnerë. Numri i pjesëmarrësve për një seance ishte, afërsisht 25 persona. Për zhvillimin e këtij trajnimi kemi

¹² https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-01_2017.pdf
Neni 8 paragrafi 8

Ne këtë cikël te trajnimeve fillon kategoria e dyte e trajnimeve. Këto trajnime zhvillohen për pjesëmarrës, te cilët vine nga radhët e Subjekteve Politike te emëruar në KQZ. Te emëruarit ne fjale, gjate ushtrimit te mandatit te tyre i nënshtronen rregullave normative te KQZ-se¹⁵, sipas te cilave janë te obliguar ti ndjekin trajnimet specifike me te cilat ndërlidhet edhe puna e tyre ne proces zgjedhore.

Programi Orientues është aktivitet i cili zhvillohet për çdo pale zgjedhje ne qendër te KQZ-se. Ne përbërje ka katër module, te cilat zhvillohen ne agjendë një Ditore. Prezantues janë bartësit e projekteve për modulet përkatëse të Agjendës, aspekti organizativ, administrativ dhe buxhetore iniciohet nga Divizioni i trajnimit. Për pjesëmarrje ne këtë program, ftohen te marrin pjese te gjithë ZLKZ-te se bashku me anëtaret e KKZ-se. Gjate realizimit te këtij programi nga te gjithë prezantuesit manifestohet përkushtimi për te zhvilluar prezantimet ne fryshtë e komunikimit interaktiv, duke iu dhënë mundësi pjesëmarrësve te parashtrojnë diskutime për çështjet më me prioritet nga te gjeturat dhe sfidat qe kemi hasur ne zgjedhjet paraprake.

Modulet e programit:

1. Te drejtat, obligimet dhe përgjegjësitet e anëtarëve te KKZ-ve gjate mandatit te tyre ne proces zgjedhore

Bartës i projektit është Drejtori i DKT.

2. Roli i anëtarëve te KKZ-ve ne aktivitetet qe e përshkojnë shërbimit votues

Bartës i projektit është Udhëheqësi i Divizionit te Shërbimit Votues

Modul paraqitet përmes tri prezantime për tri operacione:

- Periudha e konfirmimit dhe sfidimit;
- Periudha e ndërrimit te QV; dhe
- Votimi i Personave me nevoja dhe rrëthana te veçanta.

3. Roli i anëtarëve të KKZ-ve në aktivitetet gjate zhvillimit te trajnimeve

Bartës i Projektit është Udhëheqësi i Divizionit te trajnimeve.

Prezantimi është përbledhje e ecurisë se trajnimeve qe organizohen nga Divizioni i trajnimit gjate tërë procesit zgjedhore, dhe ndërlidhja operative me Zyrat e KKZ-ve. Ne këtë modul, me fokus te veçantë prezantohen, procedurat e votimit, numërimi, paketimi dhe pranimi te materialeve nga KVV-te ne KKZ, duke pasur parasysh se, vet pjesëmarrësit ne fjale, bëjnë pranimin e te gjitha materialeve te ndjeshme zgjedhore nga KVV-te tek KKZ-te ne përfundim te ditës se zgjedhjeve.

4. Roli i anëtarëve ne pranim-dorëzimin dhe dërgimin e materialeve ne QNR

Bartës i projektit është Udhëheqësi i qendrës se numërimit dhe rezultateve.

Ky modul është i një rëndësie te veçantë, sepse pranimi i materialeve zgjedhore nga KVV-te ne KKZ dhe përgatitja e tyre për dërgim ne QNR është përgjegjësi e anëtarëve te KKZ-se.¹⁶ Për këtë modul prezantimi zhvillohet nga QNR, gjate prezantimit behet shpjegim dhe ilustrim vizual i gjithë ecurisë se pranimit, evidentimit te te dhënavë ne formularin e pranimit te QNR-se, plasimi i materialeve ne hapësirat se ku dedikohen ne bazë te gjendjes faktike te kutive dhe materialeve, futjes se te dhënavë nga formularët ne sistem e deri tek arkivimi i materialeve ne hapësirat e dedikuara ne QNR.

¹⁵ https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/LIGJI_NR_03_L-073_P%C3%88RZ_ZGJEDHJET_E_P%C3%88BRGJITHSHME_N%C3%88B REPUBLIK%C3%8BN_E_KOSOV%C3%8BS.pdf

Neni 68-paragrafi d)

¹⁶ <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-18-2016.pdf>

Neni 9

Për zhvillimin e këtyre trajnimeve, çdo ekip i trajnimit ne terren pajisen me pako te trajnimit konform ekipeve ekzistuese dhe Doracak te trajnimit ne baze te numrit te anëtarëve për Komunën respektive.

Gjatë tërë kohës së zhvillimit të këtyre trajnimeve, nga qendra ka gatishmërie për të ofruar ndihme, qofte ne plotësim të materialeve te trajnimit, ashtu edhe ne raste eventuale përkrahje me trajnerë për te zhvilluar apo lehtësuar programin.

Varësisht zhvillimit dhe cilësisë se këtij trajnimi, rrjedhimisht mund te themi se është indikatorë i matjes se cilësisë se procesit zgjedhorë ditën e zgjedhjeve. Te kuptuarit e procedurave mire dhe bartja e njohurive direkt ne Vendvotim ditën e zgjedhjeve pasqyron cilësinë dhe vlerën një trajnimi te mire. Ndarma dhe planifikimi i seancave qe zhvillohen ne terren zakonisht përgatitet nga Divizioni i trajnimit vetëm si plan orientues. Plani përmban te dhënat si ne vijim: Komuna, Numri i KVV-ve, numri i anëtarëve te KVV-ve, numri i ekipeve te trajnimit, ditët e planifikuara te fillimit dhe mbarimit, për te përfunduar jo me vone se dy dite para ditës se zgjedhjeve.

Edhe ne kete cikël te trajnimit nga monitorimet e bëra nga trajnerët e qendrës, kemi te gjetura evidente te cilat tregojnë se ne disa raste jane evidentuar: Mosrespektim i Agjendës; mos lejim i zhvillimit te monitorimit për trajnerët e qendrës; tejkalim i numrit te pjesëmarrësve, me pretekste banale subjektive, vonesa dhe mungesa te pjesëmarrësve, fshehje te listave te nënshkrimeve te pjesëmarrësve ne trajnim etj.

7.7 Trajnimi i Kryesuesve te KVV-ve

Ky trajnim zhvillohet vetëm për kryesuese te KVV-ve dhe përmban modulin e njëjte si te trajnimit paraprak për procedurat e votimit, numërimit dhe paketimit te materialeve zgjedhore. Nga praktikat e mëparshme, zhvillohet një dite para ditës se zgjedhjeve duke u trajtuar si trajnim rifreskues.

VIII. **Sfidat**


Sfidat e paraqitura ne vazhdim janë pjesë e te gjeturave te cilat ne tekstin me larte i keni me te specifikuara ne trajnimet e pëershkuara, mirëpo, përbledhja ne vijim na ndihmon ti kemi pike referenca për përmirësim te trajnimit ne te ardhmen dhe njëkohësisht justifikim për rekomandimet e parashtuar.

- Mos përcaktim i çartë i kompetencave për secilën instance të Trajnimit;¹⁸
- Mos definim i çartë i detyrave, obligimeve, përgjegjësive dhe kompetencave të trajnerëve si në qendër ashtu edhe në KKZ;
- Mos transparensa në rekrutimin e stafit të trajnimit ne terren;
- Mos respektim i Agjendave te trajnimit;
- Tejkalim enorm i numrit te pjesëmarrësve ne seanca trajnimi;
- Pengesa ne monitorimin e trajnimieve, duke mos i lejuar trajnerët te monitorojnë;
- Mos përkrahje ne mbështetje për çështje administrative dhe buxhetore nga disa njësi te administratës dhe përkrahjes (ushqimi, transporti, salla jo te përshtatshme për trajnim etj.)


IX. **Rekomandimet**

¹⁸ https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-01_2017.pdf
Neni 15 paragrafi2

Anketimi i 38 respondenteve/ZLKZ



Shtoja 1. Anketa e zhvilluar me Zyrtaret e larte Komunale te Zgjedhjeve



Shtoja 2. Vendvotimet e rinumëruara për periudhën 2009 – 2019

Ky punim u realizua nga:

Valbona Kida

Udhëheqëse e Divisionit te trajnimeve



Draft

Skema e strukturës organizative te zhvillimit te trajnimeve

